



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .09.2022

MBLEDHJA Nr. 39,
Datë 12.09.2022, ora 09:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 12.09.2022, ora 09:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 39 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 06.09.2022
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Gusht 2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV dhe çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për periudhën 01.08.2022 – 31.12.2022, për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 20/10/6 kV
3. Mbi miratimin e kontratës së shit-blerjes së energjisë elektrike ndërmjet KESH sh.a. dhe OST sh.a. për mbulimin e humbjeve në sistemin e transmetimit
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “OST” sh.a. për transferimin e aseteve të investimit të kryer nga zbatimi i projektit “Supply and Instalation of Transmission Meter/Data Center” nga OST sh.a., tek OSHEE Group sh.a.
5. Mbi një ndryshim në vendimin e licencimit të shoqërisë “Breçani R.O.S.P” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec “Drita”, me kapacitet të instaluar 1980 kW
6. Mbi shqyrtimin e ankesës së konsumatorit A. Ç. ndaj Furnizuesit të Shërbimit Universal FSHU sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI